



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 464 Prot.

Tiranë, më 13 / 3 /2017

VENDIM

Nr. 48, datë 13 / 3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr.1536 Prot., datë 27.12.2016, kundër Autoritetit Publik "Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

Ankuesi nëpërmjet kërkesës për informim datë 15.11.2016 me nr.559/16 Prot, ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, vënien në dispozicion të informacionit si më poshtë:

- *Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim quajtur "KLSH") me nr.prot. 941/42 datë 30.06.2013 për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal), ndaj punonjësit të Bashkisë Sarandë?;*
- *Kopje të vendimit të marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm;*
- *Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot. 941/42 datë 30.06.2013;*
- *A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë?*

Me shkresën nr. 298/3 Prot., datë 30.11.2016 Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, i ka kthyer përgjigje kërkuarit, duke i vënë në dukje mungesën e legjitimitetit të tij në lidhje me dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara. Gjithashtu ka informuar kërkuarin se dokumentacioni i kërkuar administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ankuesi depozitoi pranë Komisionerit ankimin nr. 1536 Prot datë 27.12.2016 duke i kërkuar këtij të fundit ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Meqenëse institucioni i Prokurorisë funksionon në mënyrë të centralizuar, Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr.1536/1 Prot, datë

28.12.2016, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i kërkoi Autoritetit Publik/Prokurorisë së Përgjithshme përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 09.01.2017.

Autoriteti Publik/Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 3867/1 Prot datë 05.01.2017 (të cilën ia ka dërguar për dijeni dhe Komisionerit) i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, me rekomandimin për dhënien e informacionit të kërkuar.

Aktualisht rezulton se Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, nuk ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni sipas kërkesës së Qendrës “Res Publica” dhe shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. 3867/1 datë 05.01.2017.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” administrohet nga Autoriteti Publik/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë në kuadër të një kallëzimi penal të depozituar pranë kësaj prokurorie nga KLSH.

Rrjedhimisht në shqyrtimin e çështjes, gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” së bashku me kufizimet që ky ligj mund të përmbajë lidhur me publikimin e informacionit.

Gjithashtu duke pasur parasysh pikat 2 dhe 3 të objektit të kërkesës për informim, Autoriteti Publik, në bërjen publike të informacionit duhet të zbatojë kufizimet sipas nenit 17, pika 1 a) të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të bëjë publik informacionin në përputhje me nenin 17 pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion kërkuarit. Personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të bëjnë anonimizimin e të dhënave në përputhje me nenet e sipërcituara.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë”, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica” me nr.1536 Prot., datë 27.12.2016, ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë”, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në përputhje me nenin 17, pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” brenda datës 21. 3 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot me datë 13. 3 .2017.

